



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.659/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e ArtaYmeri, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli ArtaYmeri, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), në Vushtrri, në Vendvotimin:2708B/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e votimit, në Vendvotimet si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me nr. ZL.Anr. 659/2017 më datë 09.11.2017 në ora 13:30, nga ArtaYmeri, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, ku pretendon se në QV 2708B/01R ka poseduar 40 vota, mirëpo komisionarët gjatë plotësimit të Formularëve të Rezultateve për Kandidatë-FRK kanë bërë lëshim teknik, duke evidentuar vetëm 26 vota të kandidates në fjalë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet në apel dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar.

Paneli, me datë 11.11.2017, në përbërje të ekipit hetues të PZAP-it, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet në apel janë të bazuara, pasi që nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutin e Votimit 2708B/01R, është konstatuar se nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK) kandidati nga subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) ka poseduar 26 vota në FRK-në e cila është plotësuar në Vendvotim në ditën e votimit, ndërsa pas hetimit të bërë nga paneli, vërtetohet se parashtruesi i apelit i posedon 44 vota të vlefshme.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

ZL.Anr.659/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.